



Projekti është i financuar
nga Bashkimi Evropian

**Integrimi i pakicave etnike në
tregun e punës duke fuqizuar
potencialin e tyre për punësim**

Për çfarë projekti bëhet fjalë?

Qëllimi kryesor i projektit "Integrimi i pakicave etnike në tregun e punës duke fuqizuar potencialin e tyre për punësim" është që të lehtësojë integrimin e të rinjve nga pakicat etnike në Maqedoni dhe të rrisë konkurrencën e tyre në tregun e punës. Ky projekt gjithashtu synon të rrisë kapacitetin për punësim dhe vetëpunësim të të rinjve nga pakicat etnike, të ndihmojë në krijimin e bizneseve të reja, të krijojë forcë shtytëse që do të mundësojë ngritjen e kapaciteteve të të rinjve nga pakicat etnike si dhe mbështetje e vazhdueshme për zhvillim profesional.

Grupet e targetuara të projektit janë: të rinjtë dhe gratë që u takojnë pakicave etnike në Maqedoni, institucionet dhe organizatat relevante që punojnë në mbështetjen e grave dhe pakicave etnike, si dhe kompanitë si punëdhënës potencial.

Aktivitetet e projektit do të ofrojnë mundësi dhe benefite të shumta për të rinjtë nga pakicat etnike si:

- seanca këshilluese të karrierës
- trajnime të përshtatshme dhe kurse online për punësim dhe vetëpunësim
- punëtori kreative për gra
- trajnim për organizatat civile për kryerjen e trajnimeve online
- punë praktike në kompani të ndryshme
- gara për biznes plan dhe ndihmë financiare prej 3000 euro për 5 idetë më të mira të biznesit

Projekti do të zgjasë nga dhjetori 2015 deri në gusht 2017.

Projekti është i financuar nga Bashkimi Evropian, ndërsa implementohet nga 4 partnerët e projektit: Fondacioni YES, ZIP Institute, DAJA dhe Fondacioni Future 21.

Më shumë informata reth projektit mund të gjeni në:

www.pretpriemac.mk

www.facebook.com/pretpriemac.mk

Për informata më të hollësishme mund ta kontaktoni personin përgjegjës Nazlije Iseni

E-mail: nazlije@zipinstitute.mk

Tel: +389 71 586 602

Projekti implementohet nga





Projekti është i financuar
nga Bashkimi Evropian

**Integrimi i pakicave etnike në
tregun e punës duke fuqizuar
potencialin e tyre për punësim**

Detaje mbi aktivitetet e parapara në këtë projekt

- seanca këshilluese për orientim të karrierës për 150 pjesëmarës
- 4 trajnime dhe kurse online për punësim dhe vetëpunësim për 114 pjesëmarës
 - këtu do të përfshihet trajnimi për të shkruar CV, letër motivim dhe përgaditje për komunikim më profesional gjatë intervistës për punë
- 30 orë kurs i gjuhës angleze
- 30 orë kurs IT
- 5 punëtori kreative për 50 gra
 - këtu do të shprehet kreativiteti i grave në qepje, qëndisje, prodhimi i bizhuterisë etj.
- 3 trajnime për vetë-punësim për 36 pjesëmarës si nxitje për hapjen e një biznesi të ri
- trajnime për punësim për së paku 40 persona
- 30 pjesëmarës do të mund të kryejnë punë praktike në 15 kompani të ndryshme, me kohëzgjatje prej 2 muaj
- trajnim për 20 organizata civile për kryerjen e trajnimeve online
- 2 trajnime katërditore për edukatorë
- trajnim katëditor për fillim të biznesit të ri për 10 pjesëmarës
- 150 orë mentorim për 30 pjesëmarës
- ridizajnimi i ueb portalit <http://pretpriemac.mk>
 - krijimi i platformës për shtije online të produkteve që do të krijohen gjatë punësorive kreative
 - krijimi i verzionit shqip i të njëjtit portal
- gara për biznes plan dhe ndihmë financiare prej 3000 euro për 5 idetë më të mira të biznesit

Projekti implementohet nga

